

RAPORT AUDITIMI FINANCIAR

MBI AUDITIMIN E FONDEVE TE PERDORURA NGA PARTIA TOLERANCA E RE , NE FUSHATEN PER ZGJEDHJET PARLAMENTARE TE 28 QERSHORIT 2009

POROSITESI : KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE TIRANE

AUDITOI : PAJTIM HYSI
Ekspert kontabel i autorizuar, Nr licence 63

Periudha e mbuluar Maj deri 28 qershor 2009

Data e mbylljes 02.11.2009

Kemi kryer auditimin ligjor te detyrueshem te fondeve te perftuara dhe te shpenzuara nga Partia Toleranca e Re per fushaten zgjedhore per zgjedhjet parlamentare te 28 qershorit 2009.

Ky auditim eshte kryer ne zbatim te kontrates se sherbimit te lidhur me date 17.08.2009 me objekt : `kryerjen e auditimit ligjor te detyrueshem te fondeve te perftuara dhe te shpenzuara nga Partia Toleranca e re per fushaten zgjedhore,ne perputhje me ligjin Nr 10019 date 29.12.2008 "Kodi zgjedhor i Republikes se Shqiperise", ligjin Nr 10091 date 05.03.2009 "Per auditimin ligjor,organizimin e profesionit te Ekspertit Kontabel te Regjistruar dhe kontabilistit te miratuar", dhe ligjit Nr 9228 date 29.04.2004 "Per Kontabilitetin dhe pasqyrat Financiare" si dhe aktet nenligjore te nxjera ne baze dhe per zbatimin e tyre.

Vendi i kryerjes se ketij auditimi,edhe sipas percaktimit ne kontrate ishin ambientet e Partise Toleranca e Re, por jo ne adresen e deklaruar ne Tirane, pasi ajo ishte nje adrese provizore, aktualisht kjo Parti e ka qendren e veprimtarise ne Fushe Kruje, kurse perpunimi i dokumentacionit dhe perpilimi i raportit u be ne studion tone ne Fier.

Objekti i ketij auditimi eshte dhenja e nje opinioni per shkallen e zbatimit te kerkesave te percaktuara ne ligjin Nr 10019 date 29.12.2008 "Kodi zgjedhor i Republikes se Shqiperise", ligjin Nr 10091 date 05.03.2009 "Per auditimin ligjor,organizimin e profesionit te Ekspertit Kontabel te Regjistruar dhe kontabilistit te miratuar", dhe ligjit Nr 9228 date 29.04.2004 "Per Kontabilitetin dhe pasqyrat Financiare" si dhe aktet nenligjore te nxjera ne baze dhe per zbatimin e tyre, mbeshtetur mbi nje kontroll fizik me zgjedhje te dokumentave qe disponon subjekti zgjedhor.

Auditimi u krye ne periudhen 17.09.2009 deri ne 01.11.2009 dhe perfshiu kontrollin e te ardhurave dhe shpenzimeve te Partise Toleranca e Re te arketuara dhe perdorura per fushaten per zgjedhjet parlamentare te dates 28 qershor 2009, qe ne rastin konkret i perket periudhes maj qershor 2009.

Nga kontrolli qe ju be dokumentave te paraqitura nga subjekti u konstatua:

Evidencen dhe dokumentat per te ardhurat dhe shpenzimet per fushaten zgjedhore jane mbajtur nga ish sekretari i pergjithshem Z.Behar Sadiku deri me date 06.06.2009, dhe me pas me shkarkimin e tij nga z. Valter Zalla po me te njejten detyre, dhe jo nga financierja Z Holta Mneri.

Partia Toleranca e Re nuk ploteson kushtet sipas nenit 87 te ligjit Nr. 10019 date 29.12.2008 "Kodi zgjedhor i Republikes se Shqiperise" per te perfituar fonde publike, e per rrjedhoje nuk ka perfitime nga to.

Partia Roleranca e Re ka zbatuar piken 1 te nenit 88 te ligjit Nr 10019 date 29.12.2008 "Kodi zgjedhor i Republikes se Shqiperise" per regjistrimin e fondeve jo publike dhe vendimin e Komisinit Qendror te Zgjedhjeve "Per miratimin e modelit te regjistritte posaqem qe duhet te perdorin subjektet zgjedhore per regjistrimin e fondeve te perfituara per fushaten zgjedhore si dhe modelin e deklarates qe duhet te nenshkruajne dhuruesit ne castin e dhurimit"

Totali i te ardhurave per fushaten zgjedhore ze shumen 1252010 leke. Dhurimet jane bere kryesisht nga drejtuesit e Partise.

Partia Toleranca e Re nuk deklaroi ndonje numer llogarie te hapur ne banke e per rrjedhoje nuk eshte respektuar pika 2 e nenit 88 te ligjit Nr 10019 date 29.12.2008 "Kodi zgjedhor i Republikes se Shqiperise" per regjistrimin e fondeve jo publike dhe vendimin e Komisinit Qendror te Zgjedhjeve.

Edhe pika 3 e ketij neni, qe ben fjale per kufirin maksimal te shpenzimeve, eshte respektuar.

Edhe shpenzimet per fushaten zgjedhore jane ne masen 1252010 leke.

Nuk ka ndonje plan per natyren dhe kufijte e ketyre shpenzimeve, me perjashtim te nje vendimi te brendshem per masen e dhurimit per nje person.Ne masen me te madhe shpenzimet jane bere per karburante, udhetime e djeta, dhe shume pak per baze materiale ose publicitet.

Dokumentat u paraqiten ne trajten e shenimeve, per te cilat ne te shumten e rasteve mungonte dokumentacioni baze.

Dokumentat qe duhet te justifikonin shpenzimet e bera deri ne daten 06.06.2009 nuk jane dorzuar nga z. Behar Sadiku, i cili ate dite eshte shkarkuar nga detyra e sekretarit te pergjithshem te kesaj Partie.

Nuk jane zbatuar kerkesat qe burojne nga zbatimi i ligjit Nr Nr 9228 date 29.04.2004 "Per Kontabilitetin dhe pasqyrat Financiare"

Opinionin yne ne perfundim te kontroleve qe i gjykuam te mjaftueshme per arritjen e tij eshte se

Partia Toleranca e Re ka respektuar pjeserisht kerkesat e ligjit Nr 10019 date 29.12.2008 "Kodi zgjedhor i Republikes se Shqiperise", vetem per regjistrimin e dhurimeve, dhe nuk disponon dokumentacionin justifikues baze per shpenzimet e kryera, gjendje qe nuk na lejon te japim siguri per pamundesine e ndodhjes se gabimeve dhe mashtrimeve.

Ekspert Kontabel i Autorizuar
Pajtim Hysi (Hysaj)

Fier me 02.11.2009